

## STATUT

### SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### EUREKA GROUP SH.P.K

Në këtë statut:

- “Ligi” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

#### Kreu I

##### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

###### Neni 1

###### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 1 Tetor 2021 une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“EUREKA GROUP” SH.P.K.**

(2) Themeluesi i shoqërisë është:


- **Z. Arber Zejnati**, shtetas shqiptar, lindur ne Delvine, me 01.04.1986 mbajtes i leternjoftimit nr. 036264396, nr.personal I60401131U madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

###### Neni 2 Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqeria do te kete pjese te aktivitetit te saj keto kategori:

- Konsulence inxhinierike ne te gjitha sektoret e ekonomise dhe industrise.
- Menaxhim projekti dhe burimesh.
- Sherbime ligjore;
- Sherbime ndermjetesimi.
- Sherbime rekrutimi dhe trajnimi te burimeve njerezore.
- Analize dhe vleresim te biznesit, i strukturave operative financiare per industri te ndryshme financimeve te ndryshme, modelim i biznesit, keshillime mbi ristrukturimin e organizimin financier, studime tregu, studime plan biznesi, transaksionet dhe strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnersipe te ndyshme, negocime te termave te marreveshjes, vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre;
- Asistence per leje, certifikime, akreditime, autorizime dhe licensime nga organet publike dhe private.



1

- Ristrukturim te bizneseve ne veshtiresi, keshillime dhe asistence ne marredheniet me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik;
- Vleresim i pasurive te paluajtshme;
- Studim, Projektim dhe Mbikqyrje e zbatimit te punimeve ne ndertim, infrastrukture, transport, energetik, portuale, aeroportuale dhe telekomunikacion.
- Zbatimi i ndertimit te objekteve te ndryshme, perfshire ato civile, industriale si dhe ne restaurime;
- Vleresime mjedisore.
- Ndermjetesim i aktiviteteve te projektimit, ndertimit dhe supervizimit te objekteve me interes publik dhe privat;
- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e arkeologjise, dhe te trashegimise kulturore.
- Projektim ne restaurimin e monumenteve te trashegimise se arkitektures, veprave te artit dhe objekteve muzeale;
- Shitje dhe dhenie me qira te mallrave.
- Ofrimin e kurseve dhe trajnimeve profesionale ne fusha te tilla si hoteleri turizem dhe hosting, teknologji informacioni dhe programin, programe ne fusha te tjera te mundshme te formimit profesional.
- Ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit, operimit dhe transferimit të burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, të tilla si sistemet fotovoltaik, gjeneruesit me ere, burimet gjenerues të prodhimit te kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehësisë si dhe gjeneruesit me biomasë. Projektim dhe mbikqyrje, kolaudim te rrjeteve te telefonise dhe sistemeve te ndryshme te telekomunikacionit.
- Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhere, dhe te gjitha veprave te tjera madhere, ujesjellesave, Ujrale mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne per gjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas nenit H2 te Kodit Civil per shkak te

aritit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas nenit H2 te Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.

- Import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve industrial, bujqësore, blektorale, ushqimore, ndërtimore, elektrik, hidraulik, paisje kompjuterike dhe laboratorike, elektroshtëpiake, paisje dhe sisteme ngrohje-ftohje, audiovizive, automjeteve të makinerive dhe paisjeve te ndryshme per te gjitha fushat e ekonomise dhe industrise.
- Shoqeria mund
  - I. te marre pjese me financime ose ne menyre operative ne consortiums edhe te perkoħshme, joint venture ose
  - II. (ii) te zoteroje, te bleje ose te shese pjesemarrje ne ente, shoqeri apo ndermarrje, edhe ne faze themelimi qe kane qellime te ngjashme, komplementare apo gjithsesi te lidhura me te; jo si aktivitet paresor,
  - III. Shoqeria mund edhe te jape garanci reale dhe/ose personale, te vendose pengje, te dale dorezanese apo te vendose hipoteke edhe ne favor te te treteve.
  - IV. Shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjeter qe ka te beje me pronen e paluajtshme apo te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjeter tregtar, industrial e finanziar, te dobishem apo plotesues, me qellim permbushjen e objektit te saj, si edhe cdo aktivitet tjeter te pranuar nga ligji.
  - V. Sherbime ne fushen e pyjeve dhe kullotave, hartimi i planeve te menaxhimit, inventarizim, sherbime plotesuese dhe aktivitete te tjera qe lidhen me pylltarine.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do tē jetë me afat te pacaktuar.

**Neni 4  
Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. "Nasi Pavllo, Pall.15/1, Sh. 1, Apt. 1, Njesia Bashkiake Nr. 2 Tirane.
2. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: [www.eurekagroup.al](http://www.eurekagroup.al).
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: info@eurekagroup.al.
4. Numri telefonit eshte: +35582099447 ose +355682001885.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Selia'.

## Kreu II

### Kapitali

#### Neni 5 Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njeqind mijë) Lekë (\**sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*\*). Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme.

- Ortaku themelues Arbër Zejnati: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njeqind mijë) leke që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkësës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10 Kuorumi**

Në rastin e marres së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve.
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;


Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejtë e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.



A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized loops and lines, is placed here.

Të dhënat e identifikimit dhe specimenët e nënshkrimit: (mbiemrat, emrat, adresat):

- **Z. Myzejene Feim Zejnati**, shtetas shqiptar, lindur ne Delvine, me 29.01.1982 mbajtes i leternjsoftimit nr. 037092836, nr.personal I20129078S madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

#### **Neni 14 Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:


- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:
  - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administrator detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëdës;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'I dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti finanziar-ekspertet**

**Neni 16**  
**Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

**Neni 17  
Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe tē kontrolloje tē gjithe dokumentacionin kontabel tē veprimtarise ekonomiko tregtare tē shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike tē ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje tē tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim tē kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit tē bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike tē ushtruara, tē cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e tē drejtes vendimore qe ka.

**Kreu V  
Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18  
Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tē behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim tē Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare pēr dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në pērputhje me pikën 3 tē nenit 43 tē ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Pēr Qendrën Kombëtare tē Biznesit”;
- d) me vendim tē gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne tē cilin parashikojne menyren e likuidimit tē shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tē nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me pērjashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.


Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim pēr emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, pēr tē caktuar një likuidues.

**Neni 19  
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund tē ndahet, bashkohet sipas Vendimit tē Mbledhjes së Përgjithshme tē Asamblesë së Ortakëve, në pērputhje me dispozitat ligjore tē parashikuara në Pjesën IX tē Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Pēr tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 20  
Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU I VETËM**

**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**EUREKA GROUP SHPK**

**Arbër Zejnati**

